



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:237883

Datë: 03.02.2021

Numri i dokumentit: 01472569

**PKR.nr. 160/2020**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE GJAKOVE** –Departamenti për Krime të Rënda, me Trup Gjykes të përberë nga gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i Trupit Gjykes, dhe gjyqtarëve Drilon Haraçia, dhe Njazi M., anëtar të Trupit Gjykes, me pjesëmarrjen procesmbajtëses Nushe Kadrija, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. Xh. M. nga fshati . . . K- Rahovec, për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 prg 1 nën prg 1.3 të KPRK-se, dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 prg 1 të KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë,- Departamenti për Krime të Rënda, PP/L.nr. 45/2019, të dt. 31.08.2020, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimeve gjyqësorë publik të mbajtur më datë 03.11.2020, 05.11.2020, 03.12.2020, 04.12.2020, 31.12.2020, në prani të Prokurorit të shtetit Ali U., të akuzuarit A. M. dhe mbrojtësit të tij av. Ndrec Dodaj, të dëmtuarës K. M., dhe mbrojtësit të viktimave A. P., me dt. 05.01.2021, muar dhe publikisht shpalli ndërsa me datën 03.02.2021 përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I akuzuari: A. M.**, nga i ati Xh. dhe ëma K. e lindura H., data e lindjes . . . , në fshatin . . . K- Rahovec, ku dhe jeton, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, ka qene në paraburgim prej dt. 17.10.2019, gjerë me dt. 05.01.2021, Shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës, me numër personal ID . . .

- Gjykata komform nenit 364 paragrafi 1, pika 1.3 të KPPK-së.

### **LIROHET NGA AKUZA**

**I** . Me dt. 08.05.2019, në mes të orës 23:00/h, e gjerë në ora 03:00/h, të dt. 09.05.2019, në fshatin . . . K- Rahovec, përkatësisht në shupen e cila gjendet në katin e parë të shtëpisë tani të ndjerë me dashje dhe për motive të pa njohura ka privuar nga jeta tani të ndjerin përkatësisht vëllain e tij N. M. i moshës 33 vjeç, dhe atë duke e qëlluar me një të shtëne në revolja të kalibrit dhe tipit të panjohur në pjesën e parme të kraharorit e që sipas raportit të autopsisë rezultoi se vdekja e tani të ndjerit N. ka ardhur si rezultat i gjake derdhjes së brendshme të kraharorit si pasojë e plagës tej

shkuese neper regjionin e zemrës, e shkaktuar nga veprimi i predhës se hedhur nga arma e zjarrit.

**- me çka kishin për të kryer veprë penale të vrasjes së rëndë nga neni 173 prg 1 nen prg 1.3 te KPRK-se.**

**II.** Me parë ka siguruara dhe gjerë me datën 08.05.2019, pa autorizim ka mbajtur armë dhe municion dhe atë një revole te tipit dhe kalibrit te pa njohur e te cilën armë e ka përdorur ne mënyrën e përshkruar si ne dispozitivin I te këtij aktgjykimi, duke privuar nga jeta tani te ndjerin N. M. nga fshati . . . K- Rahovec, e cila armë nuk është arritur qe te konfiskohet pasi qe pas kryerjes se veprës penale i pandehuri te njëjtën e ka hudhur.

**-këso dore kishte për të kryer veprë penale mbajtje ne pronësi, kontrolle ose posedim te pa autorizuar të armëve nga neni 366 prg 1 te KPRK-së.**

Shpenzimet e procedurës penale bije ne llogari te mjeteve buxhetore te kësaj Gjykate.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Gjakove, - Departamenti për Krime te Rënda, Gjykatës Themelore ne Gjakove, - Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr. 45/2019, te dt. 31.08.2020, kundër te akuzuarit A. Xh. M. nga fshati . . . K- Rahovec, për shkak te veprës penale te vrasjes se rëndë nga neni 173 prg 1 nen prg 1.3 te KPRK-se, dhe veprës penale mbajtje ne pronësi, kontroll, ose posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 366 prg 1 te KPRK-se.

Gjykata ka caktuar seancat e shqyrtimit kryesor me dt. 03.11.2020, ku ka prezantuar përfaqësuesi i akuzës Prokurori i shtetit Ali U., i akuzuari A. M. se bashku me mbrojtësin av. Ndrec Dodaj, i caktuar sipas autorizimit, e dëmtuara K. M. se bashku me mbrojtësin e viktimave A. P..

Pas leximit te aktakuzës i akuzuari A. M. është deklaruar i pa fajshëm për veprat penale qe akuzohet sipas aktakuzës andaj Gjykata ka zbatuar procedurën e provave.

Përfaqësuesi i akuzës Prokurori i shtetit Ali U. ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se gjatë mbajtjes se seancave te shqyrtimeve gjyqësore verbalo – publike ne çështjen penale kundër te akuzuarit A. M. nga fshati . . . K- Rahovec, për shkak te veprës penale vrasjes se rende nga neni 173 prg 1 nen prg 1.3 te KPRK-se, dhe veprës penale mbajtje ne pronësi, posedim te pa autorizuar te armëve nga neni 366 prg 1 te KPRK-se, me pa mëdyshje nga provat e administruar gjate shqyrtimeve gjyqësor dhe atë nga provat materiale siç janë : raporti fillestar i incidentit i dt. 09.05.2019, me numër 2019 – EB-186, raporti i shpejte i dt. 09.05.2019, me numër 2019- EB- 186, raporti i oficerit policor F. C., i dt. 09.05.2019, me numër te njëjtë te rastit, raporti informuese me nr. 2019- EB-186, i dt. 09.05.2019, raporti i këqyrjes se vendit te ngjarjes i dt. 09.05.2019, skica e vendit te ngjarjes me legjende me date dhe numër te njëjte , foto albumi i vendit te ngjarjes me date dhe numër te njëjtë , raporti mjekësor i dt. 09.05.2019, te lëshuar nga dr. V. M., i

QKMF-se, ne . . . , raporti i policit B. K., me numër ID #4596, i dt. 26.07.2019, raporti i hetuesit rreshter M. G. me nr. ID# 1013, i dt. 07.05.2019, dt. 09.05.2019, 26.07.2019, raporti i hetuesit A. H. me numër ID # 3961, i dt. 14.05.2019, procesverbali për futjen e personit nen urdhër arrest aktivë ne stop listën SMK e hetuesit N. P., me numër ID #4605, i dt. 30.05.2019, raporti i hetuesit E. J., nga analiza e listingut dhe hartografisë se viktimës i dt. 31.05.2019, raporti i hetuesit te masave te fshehta te dt. 06.06.2019, raporti i hetuesit E. J., me nr. ID # 9272, dt. 21.06.2019, dhe 03.07.2019, raporti i hetuesit rreshter M. G. dt. 07.08.2019, 13.08.2019, 27.08.2019, dhe 16.10.2019, raporti plotësues i dt. 12.08.2020, raporti i hetuesit rreshter H. S. i dt. 28.08.2019, raporti i ekspertimit i përpiluar nga AKF-ja, me numër ref AKF-e, 2019- 0202 i dt. 29.05.2019, raporti i autopsisë për tani te ndjerin N. M. i përpiluar nga eksperti mjeko- ligjore dr. N. U., me nr. MA 19-121 i dt. 10.05.2019, raporti plotësues mbi autopsinë e tani te ndjerit i përpiluar nga dr. N. U., i dt. 08.09.2019, shënimi zyrtar i dt. 28.01.2020 me numër te rastit 2019- EB- 186.

Nga ekspertiza e ekspertit mjeko –ligjore dr. N. U. dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor i cili u deklaruar lidhur me raportin plotësuese mbi autopsinë e tani te ndjerit N. M. i përpiluar me dt. 18.09.2019, e qe i njëjti dha sqarime lidhur me konstatimet dhe përfundimet te cilat i ka përshkruar ne raportin e tij dhe atë duke konstatuar se temperatura e trupit është vetëm njëri nga shume elementet qe bazohet përcaktimi i kohës së vdekjes dhe kurrsesi nuk mund te përcaktohet koha e vdekjes nga krahasimi i temperaturës trupore me temperaturën e ambientit ku është gjetur viktima. Temperatura trupore dhe e ambientit janë matur rreth orës 10:10 minuta, te dt. 09.05.2019, duke dhënë vlera: temperatura e ambientit =15.3 grad celsius, temperatura trupore =27.3 grad celsius, faktorët e drejt për se drejtë qe ndikojnë në përcaktimin e kohës së vdekjes duke u bazuar ne matjen e temperaturës kufomore te ambientit janë : faktori fizik. Faktor tjerë me rëndësi është ambienti ku është gjetur dhe ku dyshohet se ka qëndruar tani i ndjerit prej momenti i vdekjes deri ne matjen e temperaturës kufomore. Ambienti ku deklarohet nga vëllai i viktimës se ka qëndruar tani me i ndjeri është ambienti i hapur , kurse ambienti ku është gjetur dhe ekzaminuar i ndjeri është i mbyllur. Ndryshimi i temperaturës gjatë natës ne krahasim me temperaturën gjate ditës ne muajin Maj mund te lëviz -10 grad celsius, kurse ne ambient te hapur lëvizja e temperaturës gjate natës dhe ditës mund te lëvizte ne - 15 grad celsius. Pas analizimit te temperaturës se natës ne mes datave 08. dhe 09.05.2019, del se temperatura gjate natës ka zbritur deri + 5 grad celsius, prandaj bazuar ne faktet te cilat janë konfirmuar ( temperatura kufomore, temperatura e ambientit te mbyllur, ndryshimi i temperaturës së ditës dhe natës, konstruksioni fizik, rrobat e veshura dhe eksperti me besueshmëri konstaton se vdekja ka ndodhur 7-13 orë para matjes se temperaturës kufomore dhe ambientit, duke pasur parasysh vete dallimin ne mes te temperaturës së ambientit gjate natës dhe ditës si dhe faktorët e potencuar si me lart koha e përafërt e momentit te vdekjes lëviz nga ora 22:00/h, e dt. 08.05.2019, deri ne ora 03. te datës 09.05.2019.

Bazuar ne raportin dhe fotografit nga vendi i ngjarjes ( vendi i shenjzuar me nr. 1 ambienti i hapur) ne oborrin e shtëpisë nuk janë gjetur asnjë shenje gjaku, pellge gjaku apo mjetit ( armën e zjarrit) dhe mjeti mbretës dhe i fortë ) qe kane shkaktuar plagët – shkuese, ndrydhëse ne regjionin e djathte murorë te kokës dhe plagës tejshkuese ne regjionin e majte te gjoksit, prandaj vendi i shënjezuar me nr. 1 përjashtohet te jete vendi i vdekjes ne mungese te provave mjeko- ligjore. Fakti i prezencës së pellgut te gjakut djathtas dhe nënë kokën e tani te ndjerit (2) si dhe sperkalat e gjakut (3) në pjesën e poshtme te derës afër kokës se tani te ndjerit besohet se vendi i ngjarjes ka qene vendi ku është ekzaminuar kufoma.

Nuk qëndron mbrojtja e te pandehurit A. M. e dhëne te prokurori i çështjes se trupi i pa jetë i viktimës N. M. ka qene i shtrirë ne bari me shpinë për toke, i cili gjendet prapa shtëpisë, dhe me pas e kishte vërejtur se nuk kishte shenja jete, te këtë rrokur me dy duart vetëm dhe ta këtë futur ne magazinë (shupë) kjo mbrojtje cilësohet ne tërësi e pa bazuar nga se nga raporti plotësues i ekspertit mjeko- ligjore dr. N. U., ku rezulton se vendi i shenjzuar me nr. 1, ambient i hapur ne oborrin e shtëpisë, aty ku pretendon se i pandehuri e ka pare viktimën pa jete, nuk janë gjetur asnjë shenjë gjaku pelge gjaku apo mjetë si armë e zjarrit, prandaj vendi i shënjezuar me nr.1, përjashtohet te jete vendi i vdekjes.

Andaj nga te gjitha te lartë cekura deklaroi se mbetem ne tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimeve juridike te dhëna ne te, dhe se ne tërësi u vërtetua se ne veprimet e te akuzuarit A. M. qëndrojnë te gjitha elementet qenësore te veprës penale te vrasjes se rende nga neni 173 prg 1 nen prg 1.3 te KPRK-se, dhe veprës penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te pa autorizuar te armeve nga neni 366 prg 1 te KPRK-se, ashtu qe i propozoi trupit Gjykuese qe i akuzuari A. M. te shpallet fajtores për këto vepra penale te gjykohet sipas Ligjit dhe te obligohet ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

E dëmtuara **K. M.**, ne fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se ndaj te akuzuarit nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesën pasurore juridike nga se këtu djali im A.i nuk është kryes i kësaj vepre penale, dhe kërkoi nga Gjykate qe i njëjtit te lirohet nga akuza.

Mbrojtësi i viktimave **A. P.** ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se; ne tërësi e mbështet fjalën përfundimtare te prokurorit te shtetit, e po ashtu e mbështet fjalën përfundimtar te dëmtuarës qe nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk i ka parashtruar kërkesën pasurore juridike.

I akuzuari **A. M.** në mbrojtje te vetë dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar, se në tërësi e ka mohuar veprën penale për të cilën është akuzuar duke deklaruar se me dt. 08.05.2019, ka punuar ne shtëpi dhe në mbrëmje kam dalur ne fshat kam pire kafe dhe me vone jam kthyer ne shtëpi, diku ne orët e mbrëmjes ka ardhur nipi im M. F. nga fshati Guri i Kuq dhe me automjetin e tij kemi shkuar ne Prizren. Atje kemi ndejt dy – tri orë, jam kthyer ne shtëpi rreth orës 23:30 min, dhe kur kam ardhur në shtëpi askush nuk ka qene i zgjuar kam shkuar ne dhomën time, e para kësaj kam shkuar te dhoma ku flenë nena ime i kam treguar qe kam ardhur, dhe kam ra ne gjumë. Vellau E. po ashtu ka qene ne dhomën e vete ne gjumë, ndërsa N.in nuk e kam pare nuk kam ditur a ka ardhur apo jo. Te nesërmen jam zgjuar diku rreth orës 06:00/h, te mëngjesit kam shkuar ne banjo dhe pas kësaj e kam hapur dritaren dhe e kam parë te shtrire N.in ne oborr kah shupa, dhe menjëherë e kam thirr djalin e mixhës Xh. M. neper mjete telefonit dhe i njëjti pas 5 minutave ka ardhur dhe vellau N. ka qene i vdekur i shtrire ne shupë, por unë ne polici kam deklaruar se e kam pare ne oborr, kështu me kane thënë anëtarët e familjes te deklaroi. Vellau im N.i ka qene i shtrire ne shpinë, kokën e ka pasur kah dritarja, ndërsa këmbët i ka pasur kah dera, dhe unë e kam prekur ne dore dhe e kam pare qe është pa shenja jete i shtanguar. Pas kësaj djali i mixhës Gj. i ka lajmëruar policinë për rastin. Ka deklaruar se me vëllain e tij i ka pasur raportet e mira, dhe nuk ka pasur probleme asnjëherë, dhe se kush e ka vra te njëjtin ai nuk dinë, por dinë se është shoqëruar me A. Th., M. Th., M. K., me këta më se shumti ka ndejtur, zakonisht ka ndejtur ne lokalin e H. Th.. Më vonë kam kuptuar qe vëllai im i ndjerë i ka pasur borxhe B. B. nga fshati . . . , ku ja ka marrë ketë borxh nuk dije, nga se i njëjti nuk me ka treguar mua e as anëtareve te familjes. Po

ashtu ka deklaruar se i ndjeri N. një kohe ka qëndruar ne Slloveni dhe ne Zvicër, ka shkuar dhe është kthyer dhe sa kam dijeni te njëjtin e ka quar B. B.. Pasi qe ka ndodhur vrasja kemi diskutuar me anëtarët e familjes se kush mund te jete kryesi i kësaj vepre unë si dhe familja ime kemi dyshuar ne shokët e tij M. K., B. B., A. Th., dhe M. Th., dhe këta munden me dite se çka ka ndodhur natën kritike dhe me ta ka nejte gjere ne momentin e fundit. Dhe sa kam dijeni i njëjti atë natë është përcjelle gjere ne shtëpi nga A. Th..

Ne pyetje te Gjykatës që deklaratën qe keni dhëne ne Prokurori me dt. 13.07.2020, ne prezencën e mbrojtësit te juaj se me dt. 09.05.2019, ne ora sa jeni zgjuar nga gjumi keni deklaruar se rreth ore 06:00/h te mëngjesit ne pyetjen pasuse se çfarë bere pasi qe jeni zgjuar keni deklaruar se pari kam shkuar ne banjo ne katin e II, i kam pastruar sytë, dhe e kam hapur dritaren e odës së burrave dhe kam pare vëllain tim te ndjeri te shtrire për toke ne bari, ishte i shtrire ne shpinë, dhe menjëherë kam zbritur poshtë kam shkuar tek vendi ku ishte i shtrire për toke i cili gjendet prapa shtëpisë, e kam prekur ne te dy duart, kam vërejtur qe nuk kishte shenja jete dhe ishte i ngrirë, dhe ka qene afër 3 -4 metra ne afërsi te magazinës, pastaj kam deklaruar se ne këtë rast me kapi paniku dhe menjëherë e keni rrokur para duarsh dhe e keni futur ne magazinë, ne te cilën ka mjete te punës, dhe keni vendosur ashtu siç ka qene jashtë dhe e keni thirrur djalin e axhës Xh., ndërsa ne mbrojtjen e juaj ne seancën e shqyrtimit gjyqësor keni deklaruar keni deklaruar se te ndjerin e keni gjetur ne shupë, dhe cila është e vërteta, i njëjti ka deklaruar se e vërteta është sot kjo deklarate ne shqyrtim gjyqësore nga se sipas sugjerimit te familjareve se mos po javë lanë fajin neve ashtu kam deklaruar ne polici e po ashtu kam deklaruar pastaj edhe ne prokurori. Në fjalën e vete te fundit ka deklaruar se është i pa fajshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarit **A. M. av. Ndrec Dodaj** ne fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: mbrojtja ne këtë çështje penale do te ndalët dhe do te paraqes vlerësimin dhe pikëpamjet e veta lidhur me gjendje faktike nga aktakuza, se sa ato kane arritur te argumentohet, te cilat fakte nga aktakuza janë te pa kundërshtueshme dhe cilat janë te kundërshtueshme dhe gjate shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar një ndryshim i madhe ne mes te gjendjes faktike nga aktakuza dhe gjendjes se fakteve pas këtij shqyrtimit gjyqësor, për te cilën akuzohet i pandehuri im, ku gjate leximit apo te elaburimit te analizave dhe vlerësimeve qe ju keni bërë provave qe janë administruar, besojmë qe Trupi Gjykuese do te merr vendim lirues.

Sipas aktakuzës se Prokurorisë i akuzuari A. M. akuzohet se ne shtëpinë e tij ne fshatin . . . me dt. 08.05.2019, ne mes orës 23:00/h, dhe gjere ne ora 03:00/h, te dt. 09.05.2019, me dashje dhe motive te pa njohura ka privuar nga jeta viktimën vëllain e tij N.in, me një te shtëne nga arma e zjarrit t e llojit te pa njohur gjere me tani. Dhe ky është përshkrimi i shkurtër i gjendjes se fakteve sipas aktakuzës se prokurorisë, te cilat fakte i vene ne barrë te mbrojturit tim.

Për vërtetimin e këtyre fakte janë administruar shume prova te natyrës formale – personale te propozuara nga Prokuroria, si dhe janë nxjerrë sipas detyrës zyrtare nga ana e Gjykatës, e po ashtu janë administruar edhe shume prova materiale te siguruar nga vendi i ngjarjes, janë dëgjuar ne cilësinë e dëshmitarëve dhe është marrë ne pyetje eksperti mjeko - ligjore, janë siguruar raporte te ndryshme qe kane te beje me listingun e nxjerrë nga vëzhgimet qe janë bere familjareve dhe te tjerëve, lëvizjet e personave dhe automjeteve natën kritike ne hyrje apo dalje se shtëpisë se te pandehurit dhe ne fund i pandehuri ka dhënë mbrojtjen e vete i cili ne tërësi e mohon veprën qe i vihet ne barrë.

Në këtë çështje penale janë dëgjuar një numër i konsiderueshëm i dëshmitarëve që janë kryesisht familjar, kushëri apo dëshmitar që e kanë njohur viktimën dhe të pandehurin janë shoqëruar nga viktimja dhe me të pandehurin dhe janë shumica bashkë fshatarë. Shumica e këtyre dëshmitarëve, kanë kaluar një pjesë me të madhe të kohës së bashku me viktimën dhe të pandehurin, dhe kanë njohuri për raportet e të pandehurit dhe viktimës, dhe me personat tjerë jashtë rrethit familjar.

E përbashkëta e të gjithë këtyre dëshmitarëve të dëshmitarëve, gjatë intervistimit në fazën hetimore, gjatë shqyrtimit gjyqësor në asnjë mënyrë nuk e potencojnë apo e sjellin në dyshim që kjo vrasje është kryer nga ana e të pandehurit, që në mënyrë kategorike vërtetohet se kryesi i kësaj veprë nuk është i pandehuri. Nga të gjithë këta dëshmitar, vërtetojnë se nuk kanë asnjë informacion për ndonjë raport jo të afërt në mes të viktimës dhe të pandehurit, vërtetojnë se natën kritike nuk kanë parë apo perceptuar ndonjë incident lidhur me ndonjë shqetësim që ka mundur të ketë i pandehuri. Disa nga këta dëshmitar siç janë motra, nëna, dhe vëllai i të pandehurit dhe viktimës, vërtetojnë se asgjë jo normale nuk kanë patur natën kritike, dhe gjatë ditës, në mbërmbje dhe gjere në kohën e ramjes në gjumë nga i pandehuri apo viktimja vërtetojnë se sjelljet e tyre në familje kanë qenë të zakonshme si çdo natë tjetër.

Dëshmitarët e tjerë që janë jashtë rrethit familjar me shumë flasin për viktimën sjelljet e tija, nga se janë shoqëruar me viktimën me shumë se me të pandehurin e të cilat është me rëndësi për tu theksuar se një pjesë e këtyre në mënyrë indirekte hedhin dyshime në kryerjen e kësaj veprë penale, në shokë të afërt të viktimës. E për të cilat prokurori ka djeni, dhe nuk do të thotë se kjo çështje penale mund të mbyllet me kaq.

Në cilësinë e dëshmitarit lidhur me ekzaminin mjeko- ligjor është dëgjuar eksperti **dr. N. U.**, si përpiluese i raportit të autopsisë, i cili nga palët dhe Gjykata është pyetur për përcaktimin e përafërt të kohës së vdekjes, bazuar në shenja të jashtme kufomor, i cili ekspert ka sqaruar kohën e vdekjes duke i referuar shenjave të hershme kufomore siç janë fiksimi i njollave të gjakut, temperaturës dhe shtangimit, dhe sipas ekspertit pas ekzaminimit nga mjekësia ligjore të cilët kanë qenë në vendin e ngjarjes dhe kanë matur temperaturën trupore të ambientit ka qenë shumë profesionale dhe me besueshmëri të lartë, konstaton se koha e vdekjes ka ndodhur si në përshkrimin e raportit plotësues të ekspertizës. I njëjti ekspert ka vërtetuar se vdekja është shkaktuar në mënyrë të dhunshme nga arma e zjarrit duke përshkruar shkaktuesin e vdekjes vrimën hyrës dhe dalje në trupin e viktimës.

Pa fajësi e të pandehurit e vërtetojnë të gjitha provat materiale që janë siguruar nga vendi i ngjarjes e marruara nga trupi i viktimës dhe disa nga ato që është supozuar se ka mundur të ketë kontakt i pandehuri janë dërguar në ekzaminimin në agjensinë përkatëse nga të cilat nuk ka rezultuar asgjë që involvon të pandehurin në kryerjen e kësaj veprë penale. Andaj duke u bazuar në të gjitha këto prova formale dhe materiale rezulton se aktakuza është me tepër se paragjyquese, është ngritur vetëm në baze të faktit se i pandehuri gjatë intervistimit në fazën e hetimit ka dhënë një version të tij se si dhe ku e ka parë viktimën fillimisht i cili thotë se e ka parë në oborr dhe e ka bartur në vendin ku është gjetur edhe zyrtarisht në shupke në kuadër të shtëpisë së banimit. Se si dhe pse është deklaruar kështu i pandehuri në sqaroi në seancë, dhe se fillimisht se po arrestohet ai dhe vëllai i tij për faktin se është gjetur i vdekur në shtëpinë e tyre dhe sipas tyre policia mund të dyshoi me se shumti në vetë të pandehurin apo ndonjë anëtare të familjes. I pandehuri edhe në intervistimin e tij në prokurori ka treguar realitetin mbrojtësit se ku dhe si e ka gjetur kufomën me gjitha atë është këshilluar që të qëndroj pranë versionit që ka dhënë në polici

dhe se mbrojtja mund të jete me e favorshme për te, ne konsultime me mbrojtësin e tij me siguri se edhe mbrojtësi ka vlerësuar se mbrojtja me e mirë është ashtu siç ka deklaruar ne polici, dhe te njëjtin version e ka deklaruar edhe ne prokurori. Pra ky është rast tipit i këshillimit e gabuar pasi asnjë nga provat e tjera që janë administruar nuk e vërtetojnë ne asnjë mënyrë involvimin e te pandehurit ne kryerjen e kësaj veprë penale, pavarësisht se si mbrohet i pandehuri, dhe se prokuroria ka ngritur aktakuze vetëm me një deklaratë te pandehurit e cila deklaratë nuk ka mbështetje ne provat tjera, pavarësisht se ai deklarim a është pohues apo mohues. Pavarësisht mbrojtësi i te pandehurit, ajo mbrojtje duhet te vlerësohet ne raport edhe ne provat tjera, ku ne rastin konkret nuk është vlerësuar ne këtë drejtim vetëm ka njoftuar një deklarim i te pandehurit pasi që viktima është gjetur pa shenja jete ne shtëpinë e përbashkët familjare, dhe se prokurori ka abstraktuar ne tërësi dhe fare nuk ka vlerësuar provat tjera e te cilat provat përjashtojnë ne çdo mënyrë te pandehurin nga kryerja e kësaj veprë penale.

Mbrojtja e te pandehurit gjate shqyrtimit gjyqësor e mbështetin te gjitha provat që janë administruar gjate shqyrtimit gjyqësor ashtu që Gjykata nuk ka asnjë arsye që te mos i fali besimi kësaj mbrojtje. Është më rëndësi për te theksuar se gjate procedurës hetimore, me urdhër te prokurorit, janë ndërmarre një mori veprimesh hetimore duke i vëzhguar dhe përgjuar familjaret e te pandehurit, janë nxjerr dhe siguruar disa CD-e nga kamerat e vendosur ne pjese te caktuar te fshatit që kane monitoruar çdo lëvizje hyrje dalje ne fshat dhe me asnjë prove te siguruar nga këto veprime hetimore nuk është vërtetuar se i pandehuri është kryes i kësaj veprë penale.

Nga përvoja dhe praktika gjyqësore jo me pak raste kryerja e një veprë behet në një vend , trupi i viktimës gjendet ne vendin tjetër, e krejt kjo behet me qellim që mos te vije gjere te zbulimi dhe kapja e kryesit, nga se ne rastin konkret i tere hetimi është drejtuar duke filluar nga vendi ku është gjetur kufoma pa e shiquar mundësinë se a ka mundur viktima te vritet edhe jashtë shtëpisë, me shpejtësi te silltet ne vendin ku është gjetur, nuk e ka eliminuar dhe mundësinë tjetër se dikush ka mundur te hyjë ne shtëpinë e viktimës dhe te privoi nga jeta aty dhe ku është gjetur, dhe kjo mundësi objektive për kryerjen e kësaj veprë janë te mundshme, kur kësaj i shtohet edhe shume indikacione që janë vërtetuar nga intervistomi i parë i dëshmitareve ne polici, e kane hapur dilemën se edhe dikush tjetër ka pasur interes apo qellim që te kryej ketë veprë penale, pasi që viktima sipas atyre dëshmitareve nuk ka qene person që nuk ka pasur problemeve te natyrave te ndryshme.

Prandaj pranë gjendjes se përshkruar te fakteve, pa mëdyshje rezulton se i akuzuari A. M., nuk e ka kryer veprën penale siç akuzohet nga se prokurori nuk ka arritur ti provoi faktet apo pretendimet e ngritura ne aktakuze por këto kane mbetur ne nivel te supozimeve apo pa qartësisë rreth fakteve vendimtarë. Andaj trupi Gjykuese me rastin e vlerësimit dhe analizimit te provave te administruara do te bindet që ne rastin konkret nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprë penale për te cilën akuzohet dhe ne rastin konkrete Gjykata duhet te merr aktgjykim lirues.

Gjykata ka zbatuar procedurën e provave ka marrë ne pyetje dëshmitarët e propozuar në aktakuzë, ka lexuar raportet fillestar te incidentit , ka bere leximin e raporteve policor , raportin e shikimit te vendit te ngjarjes, skicën e vendit te ngjarjes me legjendë, foto albumin e vendit te ngjarjes, raportin e Agjensionit Kosovar te Forenzikës te eksperteve për grimcat e barutit dhe zjarrevenjë, raporti mjekësor te autopsisë për tani te ndjerin N. M., i përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor dr. N. U. si dhe ka bere shikimin e raportit plotësues mbi autopsinë, dhe ka lexuar provat tjera materiale te propozuara ne aktakuzë.

Gjykata ka marrë ne pyetje në cilësinë e dëshmitares **K. M.** për ndryshe nëna e te akuzuarit dhe te ndjerit, e cila ka deklaruar se : te ndjerin N. e ka djalë e po ashtu te akuzuarin A. djalë, dhe se me djemtë nuk ka pasur asnjëherë mos marrëveshje. Natën e fundit kur e kam pare N.in ka qene dt. 08.05.2019, aty rreth orës 20:00/h, ka ardhur në shtëpi ka qene muaji Ramazan, dhe unë me vajzën kemi qene duke ngrenë iftar, e luta edhe ai te na bashkohet me tha se nuk është unët, e pas atij momenti ka dalur dhe nuk dije se ku ka shkuar. Atë natë rreth orës 22:00/h, se bashku me vajzën time kam ra me fjete ne katin e I te shtëpisë, ndërsa N.i e ka pasur dhomën ne katin e II përmbi dhomës time. Të nesërmen rreth orës 06:00/h, jam zgjuar dhe djali im A.i ka pasur qe te shkoj ne Prizren me ba një kontroll mjekësore unë kam shkuar ne punë te mija dhe po sa ka dal është kthyer te unë dhe prej frikës se po dal unë kah dyert dhe është ulur aty duke me thënë se N.i ka bere ndeshje, dhe nga ky moment e kam humbur vetëdijen, unë nuk kam lëvizur nga dhoma, e me vonë ka ardhur mjeku dhe kam marrë një gjilpërë dhe kam pa plote njerëz qe kane ardhur ne shtëpi. Gjate asaj nate nuk kam dëgjuar ndonjë zhurmë apo krismë dhe sipas meje çdo gjë ka qene ne rregull. Sa kam dijeni unë djali im N.i nuk ka pasur probleme me askënd, ka punuar jashtë Kosove ne Slloveni dhe ne Zvicër, ndërsa ne shtëpi është marr me bujqësi, derisa ka qene ne Zvicër atje ka qene i dënuar me burgim dhe pasi e ka vuajtur dënimin është kthyer ne shtëpi. Këtu i akuzuari A. nuk është vrasës i djalit tim, nga se këta kurrë nuk kanë pasur probleme me njeri tjetrin por djalin tim dikush e ka vra dhe e ka prua ne shtëpi, kush e ka bere këtë unë nuk dije. Por sigurisht me personat ne te cilët ka ndejtur, dhe është shoqëruar me ta.

Gjykata ka marrë ne pyetje ne cilësinë e dëshmitares **L. M.** e cila ka deklaruar se: te ndjerin N. e ka vëlla, ashtu edhe te akuzuarin A. e ka vëlla, dhe se natën kritike diku rreth orës 20:30 min, se bashku me nënën kane shkuar te axha R. i cili i kishte thirre për ditëlindjen e mesës se tij, para se te shkojnë te axha janë ulur për te ngrenë iftar aty rreth orës 20:00/h, dhe ne këtë moment ka ardhur i ndjeri N. i cili është ulur ne tavolinë, por nuk ka ngrenë iftar, aty ka qëndruar për afërsisht 10 minuta, dhe pasi e kishin thirr qe edhe ai te shkoj me ta për ditëlindje nuk ka shkuar me ta, ka dalur jashtë dhe pas kësaj ka shkuar dhe është larguar nga shtëpia. Ata janë kthyer ne shtëpi rreth orës 22:00/h, se bashku me nënën kam ra ne gjumë. Gjatë natës nuk kam dëgjuar kurrfarë zhurme apo krisma te armës dhe nuk dije s e kur është kthyer N.i ne shtëpi, dhe në mëngjes kam qene ne gjumë, me kane qar prej gjumit dhe nëna me tregoi se N.i ka bere ndeshje. Aty kam parë vëllezërit e mije A.in si dhe axha larët. Ka deklaruar se natën kritike vëllai i saj A.i është kthyer ne shtëpi rreth orës 23:00/h, ndërsa vëllai tjetër E.i rreth orës 23:30 min, dhe te njëjtit kane shkuar ne dhomat e veta dhe kane ra ne gjumë, ndërsa N.i kur është kthyer nuk dije dhe sigurisht këtë vrasje e kane kryer shokët e tij e jo vëllai im, nga se këta i kane pasur raportet e mira.

Gjykata ka marrë ne pyetje ne cilësinë e dëshmitares **F. M. Q.**, e cila ka deklarua se: te ndjerin N. M. e ka njohur përmes bashkëshortit te saj A. Th., dhe për here te pare me te është takuar ne shtëpinë e L. V. ne fshatin . . . , nga se L. V. ne atë kohe ka qene i martuar me motrën e saj E. Q.. Natën kritike me dt. 08.05.2019, rreth orës 20:00/h, se bashku me bashkëshortin kemi shkuar te lokali te “. . .“, ne fshatin . . . , ku ne tavolinë kemi qene te ulur se bashku me te ndjerin N., dhe S. Th.. Në ndërkohe ne lokal ka ardhur M. K., M. Th., dhe B. B.. Në ndërkohe B. se bashku me N.in kane dalur jashtë e pas tij ka dalur edhe M. K. jashtë lokalit, lokali ka pasur derën e hapur dhe kam dëgjuar se N.i i ka pasur borxhe B.t, shumen prej 10.000€. Dhe se ky borxh ka qene nga se i ka pasur pare me fajde. Gjersa ka nejtur N.i ne tavolinë disa here ka pasur thirrje telefonike dhe çdoherë është qar nga



tavolina ka hyre ne banjo atje ka biseduar dhe se sa e kam vërejtur i njëjti ka qene shume i shqetësuar, por nuk kam dëgjuar përmbajtjen e bisedave ne telefon nga se ka dalur jashtë. Pasi qe është kthyer brenda ne tavolinë ka kërkuar qe te shkoj ne shtëpi dhe ka kërkuar nga burri im A. te qoi ne shtëpi. Dhe bashkëshorti im A. e ka qar ne shtëpi dhe është kthyer prapë, dhe se kjo ka qene rreth orës 23:00/h. Për vrasjen e N.it kam dëgjuar të nesërmen në ora 07:00/h, ngase A. më kishte qar mesazhin që e kin vrasë N.in. Kush e ka vrasë N.in nuk kam njohuri, por e di që i njëjti ka pasur probleme, ka plasur borxhe, shkonte nëpër muzikë.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarit e ka marr në pyetje **XH. R. M.**, i cili ka deklaruar se të ndjerin N. e ka djalë të axhës dhe me te ka pasur raporte të mira, i njëjti ditën kritike ka qenë në shtëpinë e tij diku rreth orës 14:00, aty ka qëndruar rreth dy orëve e në ndërkohë ka ardhur shoku i tij M. K. dhe ka shkuar me te dhe më pas prapë është kthyer dhe unë diku rreth orës 19:30 minuta, e kam qar në shtëpi të tij. Të nesërmen dikund rreth orës 06:00/h të mëngjesit e ka telefonuar djali i axhës A.i, dhe i ka thënë se N.in e ka gjete të vrasë në shtëpi, unë menjëherë kam shkuar në shtëpinë e tyre dhe tek dyrtë e oborrit e kam takuar A.in, e kam vetë se çka ka ndodhur dhe në oborr të shtëpisë nuk ka pasur asgjë dhe trupi i pa jetë ka qenë në garazh ku i kanë pasur mjetet e punës. N.i ka qenë i shtrirë në shpinë, këmbët i kishte tek dera e hyrjes ndërsa kokën nga pjesa e brendshme e garazhës në të djathtë dhe menjëherë e ka kuptuar që i njëjti ka qenë i vdekur, ku menjëherë pas kësaj e kemi lajmëruar policinë në ndërkohë policia ka ardhur dhe ka bërë shikimin e vendit të ngjarjes. Sa kam njohuri unë i ndjeri N. nuk ka pasur probleme familjare me familjarët e vetë por i njëjti ka pasur shoqërinë e keqe, i njëjti më së shumti ka ndenjtë me M. K., A. Th.n, B. B.n dhe këta persona mujnë me ditë se kush e ka vrasë N.in. I njëjti ka pasur edhe raporte të biznesit me këta persona. Më vonë kam kuptuar se nga B. B. ka marr të holla hua apo me fajde nuk e di, por jam i sigurve që i ndjeri N. raportet në familje i ka pasur të mira, asnjëherë nuk kam dëgjuar që të njëjtit kanë pasur probleme, sa i përket shokëve që është shoqëruar mendoj se këta kanë pasur raportet e biznesit, shka kanë bërë mes veti nuk e di.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarit e ka marr në pyetje **B. B.N**, i cili ka deklaruar se të ndjerin N. e ka njohur që një kohë të gjatë, me te nuk ka pasur kurrfarë mosmarrëveshje. Herën e fundit që është takuar me të ndjerin ka qenë data 08.05.2019, diku rreth orës 20:00/h, të njëjtin e ka takuar në fshatin . . . , në restorantin “. . .”, të njëjtin para kësaj e kam thirre në telefon mirëpo telefoni nuk i ka punuar andaj e kam thirre A.n, i cili ka qenë shok i ngushtë i tij dhe e kam vetur se mos është N.i aty, ai ka thënë se po dhe pastaj kam shkuar në lokal, fare nuk kam hyrë brenda, e kam thirr N.in për të biseduar në lidhje me borxhin që më ka pasur në shumë prej katërmijë (4.000) Euro, të cilat të holla i kam dhënë ngase i njëjti ka pasur një aksident të komunikacionit dhe se automjetin e ka pasur me qira. N.i ka thënë se për momentin nuk ka të holla por do të siguroi ti bjerë sa më shpejtë dhe pas kësaj menjëherë ka vazhduar ka shkuar në Rahovec ngase ka pasur punët e veta private ndërsa N.i është kthyer në lokal. Të hollat që i ka dhënë nuk i ka dhënë me fajde, dhe të njëjtat të holla ende sot e kësaj dite nuk mi ka kthyer. Të njëjtit i kam ndihmuar kur ka dalë jashtë, ka punuar në Slloveni dhe në Zvicër. Pasi që ka ndodhur vrasja jam takuar me vëllain e të ndjerit me E.in me djalin e axhës Xh. dhe se të njëjtit kanë kërkuar ndihmë nga unë që të zbulohet se kush është vrasësi, unë sa kam pasur mundësi i kam ndihmuar dhe të hollat e mia i kam kërkuar nga vëllai i tij E.i por të njëjtit nuk mi kanë kthyer. Po ashtu të njëjtit i ka ndihmuar, i ka kërkuar të holla kur ka dalë jashtë Kosove, ka punuar në Zvicër por këto të holla që i kam dhënë hua i njëjti mi ka kthyer, andaj për këtë arsye i kam dhënë borxh dhe herën tjetër.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarit e ka marr në pyetje **M. XH. TH.**, i cili ka deklaruar se të ndjerin N. e ka pasur djalë të dajës dhe se ditën kritike me datën 08.05.2019, diku rreth orës

14:00/h, e ka thirr në telefon djali i dajës A.i dhe pasi që ka përfunduar orarin e punës në mbrëmje së bashku me te kanë shkuar në Prizren në “. . .”, dhe aty është ndarë me A.in ngase ai ka pasur disa punë të veta dhe pas një kohe i njëjti është kthyer, janë takuar bashkë dhe rreth orës 23:30 minuta janë kthyer nga Prizreni dhe djalin e dajës A.in e ka lanë tek shtëpia tek dyert e shtëpisë dhe i njëjti është kthyer në shtëpi të vetë. Sa kam njohuri nipi imë në familje i ka pasur raportet e mira dhe nuk kam njohuri që i njëjti ka pasur ndonjë konflikt apo mos marrëveshje në familje. Për vrasje kam dëgjuar të nesërmen dhe se natën kritike që kam ndejtur me A.in nuk kam parë që i njëjti ka qenë i shqetësuar apo diçka tjetër. Më vonë kam kuptuar se i ndjeri N. ka marrë pare personave tjerë a i ka marr hua apo me kamatë nuk e di.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarit e ka marr në pyetje **A. A. TH.**, i cili ka deklaruar se: se të ndjerin N. M. e ka pasur shok që nga femëria dhe me te është shoqëruar, me të njëjtin ka shkuar edhe nëpër lokale, kanë shkuar bashkë në muzikë dhe i nderi N. nuk ka qenë problematik. I njëjti ka qenë në Zvicër, ka shkuar 2-3 herë dhe është kthyer dhe i njëjti herën e fundit është arrestuar në Shqipëri, sipas arrestit ndërkombëtarë dhe pas qëndrimit në burg në Shqipëri është ekstraduar në Zvicër. Pasi që është kthyer nga Zvicra pas një kohe të shkurtër ka ndodhur kjo ngjarje tragjike. Ka pasur njohuri që i ndjeri N. i ka pas borxh B. B.t dhe se i njëjti nuk ka pasur mundësi të ia kthej borxhin. Sa ka njohuri i njëjti nuk ka pasur probleme familjare. Ditën kritike me datën 08.05.2019, para se të ndodhë vrasja i ndjeri ka qenë në lokalin “. . .”, me pronar S. Th., i njëjti ka ardhur rreth orës 20:00 apo 20:30 minuta, ka ndejtur një gjysmë ore dhe ka kërkuar nga unë që ta qoj në shtëpi duke më thënë se ka harruar telefonin. Kur ka ardhur N.i në lokal në tavolinë kamë qenë unë S. Th. dhe bashkëshortja ime F. Q.. Të njëjtin e kam qar deri në shtëpi, e kam lënë tek dyert e shtëpisë dhe unë jam kthyer prapë në lokal dhe aty kemi ndenjur gjerë në ora 01:30 të mëngjesit. Diku rreth orës 22:30 minuta, e kam thirr N.in në telefon por i njëjti nuk më është përgjigjur. Të nesërmen rreth orës 07:30 minuta, kam kuptuar që është vrarë N.i dhe po të njëjtën ditë në mbrëmje ka ardhur policia dhe kam dhënë deklaratë. Para se të shkoj të jap deklaratë ka ardhur tek unë djali i axhës së tij R. M. dhe më ka vetë se N.in a e ke pruar të gjallë apo të vdekur në shtëpi, i kam thënë se e kam pruar të gjallë, e ka lanë tek dyert e çka ka ndodhur pastaj unë nuk kam njohuri. I ndjeri N. sa e kam njohuri unë nuk ka pasur probleme në familje. Naten kritike derisa kemi ndejtur në lokal me N.in ka ardhur B. B., ka folur me N.in jashtë lokalit dhe unë kam pasur njohuri që i njëjti i ka pasur borxh B.t të holla, dhe për këtë borxhe N.i ka qenë shumë i shqetësuar. Biseda që është zhvilluar në mes të N.it dhe B.t ka qenë jashtë lokalit tek dyert të automjetit të B.t dhe kurrkush këtë bisedë nuk e kemi dëgjuar. I njëjti ka deklaruar se nuk kam njohuri se kush ka mundur me e kryer këtë vrasje, edhe pse familjarët e tij në fillim kanë dyshuar tek unë ngase më kanë vetur se a ia kam pruar të gjallë apo të vdekur në shtëpi, i kam kthyer përgjigje se e kam pruar të gjallë.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarit e ka marr në pyetje **M. B. TH.**, i cili ka deklaruar se: të ndjerin N. M. e ka njohur, është bashkëfshatar i tij dhe e ka pasur kojshi, ka ndejtur shpesh me te në lokalet e fshatit . . . I ndjeri N. disa herë ka shkuar në Zvicër, është kthyer dhe kam njohuri që i njëjti është arrestuar në Shqipëri pasi që ka bërë një problem në Zvicër dhe më vonë është liruar dhe ka ardhur në shtëpi në fshatin . . ., dhe më ka thënë se ka dalë i pafajshëm. Natën kritike me datën 08.05.2020, ka qenë muaji Ramazan dhe atë ditë kam punuar dhe në mbrëmje pasi që kam hëngër iftare, kam shkuar diku rreth orës 20:00/h, në Prishtinë dhe vonë jam kthyer në shtëpi dhe kam ra në gjumë dhe kjo ka qenë para syfyrit. Të nesërmen në mëngjes unë kam qenë në gjumë dhe baba imë më ka njoftuar se N.in e ka vra dikush dhe kush e ka bërë këtë unë nuk kam njohur.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarit e ka marr në pyetje **E. XH. M.**, i cili ka deklaruar se: të ndjerin N. e ka vëlla dhe se ditën kritike me datën 08.05.2019, në mëngjes rreth orës 09:00/h, ka shkuar në Prishtinë, kam kryer punë, jam kthyer nga Prishtina e më vonë kam shkuar në Gjakovë, kam pasur termin tek dentisti, jam kthyer në shtëpi, kam punuar në baçen në shtëpi ku në mbrëmje kam dalë me djalin e mixhës, kemi shkuar në fshatin . . . , kemi hangër darkë. Jam kthyer diku rreth orës 21:30 minuta e kam lanë djalin e mixhës tek shtëpia e tij dhe jam kthyer prapë në lokal te “. . .” ngase atë natë ka pasur lojë të futbollit. Aty e kam takuar edhe vëllain tim N.in, dhe i njëjti nuk ka ndejt shumë, ka dalë nga lokali ka shkuar dhe unë kam vazhduar të ri në lokal për ta shikuar lojën së bashku me M. M.. Kur kam shkuar në shtëpi menjëherë kam shkuar në dhomën time, kam ra në gjumë dhe se derën e oborrit të shtëpisë e kam gjetur të çelur dhe qeni nuk ka qenë i lëshuar dhe e kam ditur që N.i nuk ka qenë në shtëpi ngase ai çdo herë në mbrëmje është thyer në shtëpi dhe çdo herë e mëshilke derën e oborrit dhe e lëshonte qenin, e pasi që qeni ka qenë i pa lëshuar kam supozuar se N.i nuk është në shtëpi dhe kam ra në gjumë. Të nesërmen në mëngjes diku rreth orës 06:00/h apo 06:30 minuta, më ka thirrë djali i mixhës Xh. M. duke më thënë se të dali tek dyert e oborrit, jam zgjuar, kam zbritur poshtë dhe në shup ku i mbajmë sendet e punës për fundi odës në hyrje e kam parë të ndjerin N., ishte i shtrirë në shpind për toke dhe në vendin e ngjarjes nuk ka pasur ndonjë armë apo diçka tjetër aty kam takuar djalin e axhës Xh., i cili më tha se N.i është i vdekur, nuk po lëvritë fare, po ashtu ka qenë edhe vëllai im A.i dhe afër trupit të ndjerit ka vërejtur vetëm gjak dhe disa gërvishtje në fytyrë dhe i njëjti ishte i veshur me rrobat që i ka pasur gjatë ditës. Menjëherë pas kësaj kemi lajmëruar policinë, ka ardhur policia dhe ka bërë shikimin e vendit të ngjarjes ndërsa kufomën e kanë dërguar për obduksion. I ndjeri N. në familje nuk ka pasur probleme me askënd por e ka pasur shoqërinë e keqe dhe siç jam informuar të nesërmen se shoku i tij A. natën kritike e ka pruar prej lokalit deri në shtëpi dhe prej atij momenti që ka hyrë në kerr me A.n ai ka qenë i fundit që e ka pruar në shtëpi, a e ka pruar të vdekur apo të gjallë nuk e di por sigurisht në këtë çështje janë të përfshirë shokët e tij A., M. dhe M. Th., e kurrsesi vëllai imë A.i.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarit e ka marr në pyetje **G. A. TH.**, i cili ka deklaruar se të ndjerin N. M. e ka pas bashkëfshatarë, me te ka qenë në të njëjtën klasë nga shkolla fillore, me te është shoqëruar. Ka njohuri që i njëjti ka qenë në Zvicër dhe pasi që është kthyer nga Zvicra është takuar me te, ka pi kafe. Para se të ndodhë vrasja i njëjti i ka kërkuar tre (3) fishek të revoles TT, dhe nuk më ka treguar se për çka i nevojiten këta fishekë dhe këto fishek i kam dhënë më vonë, kam shkuar në shtëpi ngase fishekët i kam pasur në fermë të pulave dhe të njëjtat i kam dhënë dhe nuk ka qenë prezent kush kur i kam dhënë dhe as kur mi ka kërkuar. Nuk ka pasur njohuri që N.i i ka pasur dikujt borxh dhe nuk ka dijeni që i njëjti është marr me shitblerjen e drogës apo ka marr pare me fajde. Për vrasje kam dëgjuar nga baba i tij dhe vëllai dhe nuk kam njohuri tjera në lidhje me këtë çështje.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarit e ka marr në pyetje **M. R. M.**, i cili ka deklaruar se: të ndjerin N. M. e ka njohur ngase ka qenë bashkëfshatar me te dhe ka pasur raporte të mira, i njëjti është shoqëruar me te si dhe me vëllezërit e tij dhe sa ka njohuri ai këta i kanë pasur raportet e mira në familje. Sa i përket rastit të vrasjes unë nuk kam njohuri si ka ndodhur kjo vrasje, ngase nuk kam qenë dëshmitarë okularë por për vrasje kam marr vesh si kojshi që kam pas.

Me P.in e të gjitha palëve gjykata ka lexuar deklaratat e dëshmitarëve L. S. V., M. S. K.t si dhe P. S. M., pasi që të njëjtit kanë qenë të pa arritshëm për organet e ndjekjes, pasi që të njëjtit janë të punësuar jashtë Kosove.

Dëshmitari **L. S. V.** në deklaratën e tij të dhënë në Polici me datën 24.05.2019, ka deklaruar se të ndjerin N. M. e ka njohur që nga shkolla fillore dhe se pesë ditë para se të vritej me të njëjtin kanë shkuar në Prizren me shoqen e tij nga Sh. V. dhe bagjanakeshen M., dhe pasi kemi shkuar në Prizren kemi ndejtur dhe jemi kthyer në fshatin . . . Një natë pas takimit në Prizren N.in e kishte thirr në telefon A. dhe i kishte thënë të vij tek lojkali . . ., dhe unë së bashku me L. dhe V., kemi shkuar, jemi takuar dhe pas kësaj kemi shkuar në fshatin . . . në restorant “te . . .” ku ka pasur muzik të gjallë dhe aty kemi qëndruar deri në ora 01:00 pas mesnate. Me datën 09.05.2020 kam dëgjuar se është vrarë N.i dhe pastaj e ka thirr djalin e axhës së N.it, e ka vet për rastin i cili i ka thënë se nuk di kurrëgjë për rastin. N.i pasi ka dal nga burgu i ka thënë A.t se i ka punët keq dhe ka ardhur 2-3 herë në Gjakovë për tu takuar me do persona me vendasit e tij ngase i njëjti ka pasur të lidhur biznesi me ta, po ashtu cek se me datën 08.05.2020, sa ka qëndruar në lokalin “ . . .” me N.in aty kishte ardhur një person me një vetur “. . .” që është nga fshati . . ., dhe sipas kërkesës së tij N.i ka dal jashtë, ka biseduar me te dhe nuk e din se ky person a i ka kërkuar apo dhënë të holla.

Dëshmitari **M. S. K.** në deklaratën e tij të dhënë në Pokurori me datën 08.11.2019, ka deklaruar se të ndjerin N. e ka njohur që nga femëria. Me te nuk ka pasur asnjëherë konflikt apo mosmarrëveshje dhe se kur kanë patur kohë kanë ndejtë së bashku nëpër kafe dhe nuk është në dijeni se ka pasur mos marrëveshje me familje apo me persona tjerë. Gjerësa kanë qëndruar bashkë nuk është shprehur asnjëherë shqetësim për asgjë. Ditën kur ka ndodhur rasti kritik me datën 08.05.2019, këtë ditë para se të ndodhë rasti ka qenë në shtëpinë e tij diku rreth orës 17:00 pas dite pasi që N.i e kishte telefonuar që të pinë kafe dhe me makinën e tij “. . .” Ka shkuar e ka marr tek shtëpia e Xh. M. dhe i ndjeri ka ardhur te xhami i makinës duke i thënë që të shkoi se dua ende të ri te djali i mixhës së Xh.it, dhe ky ka vazhduar rrugën e vetë për të shkuar në fshatin . . ., ka shkuar tek berberi dhe telefonin e kishte lënë në makinë. Në ndërkohë N.i e kishte thirrë dy herë në telefon dhe kur është kthyer në makinë diku rreth orës 20:00, kishte parë thirrjet që i ka bërë N.i dhe e ka thirrë që të shkoi në fshatin . . . në lokalin kafiterinë “Diki” me pronarë S. Th.. Ka shkuar në këtë lokal dhe atë natë është zhvilluar një lojë futbollit dhe është ulur në tavolinë së bashku me S. Th.n, A. Th.n, Z. M. dhe M. Th.n, dhe ka pasur edhe persona tjerë nëpër tavolina dhe gati të gjithë i kam njohur dhe unë kam vetë për N.in dhe A. ka treguar se e ka dërguar në shtëpi. Aty në lokal ka qëndruar rreth 2 orë dhe rreth orës 23:00 ka shuar në shtëpi, ka ra në gjumë dhe të nesërmen ka kuptuar se N.i ka qenë i vramë, ashtu që menjëherë ka dalë nga shtëpia, ka shkuar tek lokali “. . .” dhe ka vërejtur se policia ka qenë tek dyert e oborrit të N.it. Gjatë shoqërimit që kam pasur me të ndjerin N. ai nuk i kishte thënë që i kishte dikuajt borxh apo të ketë mosmarrëveshje me dikëndë.

Dëshmitarja **V. B. M.** në deklaratën e sajë të dhënë në Polici me datën 30.05.2019, ka deklaruar se para një viti ka takuar L. V.n pasi që e njëjta është shoqëruar me gruan e L.it. Gjatë kohës sa ka qëndruar në Kosovë te L.i ka shkuar në muzikë live aty ashtë takuar edhe me M. K. dhe N. M.. Katër ditë para se të virtet N.i ajo kishte ardhur nga Tirana me autobus dhe në autostradë ka ndalur dhe e ka marr N. M. dhe M. K. me veturën e tyre, dhe pastaj të njëjtën e kanë dërguar tek shtëpia e L.it, po ashtu ka deklaruar se gjatë kësaj kohe sa ka qëndruar tek L.i kanë shkuar në muzik me të ndjerin N. dhe M.n, edhe në këtë raste e kishin qarrosur me një sasi të kokainës dhe pasi që e kishte provuar kokaina ka qenë shumë e dobët dhe derisa ishte aty N.i i kishte thënë se “kam sa të duash mos ki derte”, dhe gjatë rrugës kishte telefonuar M.

për ti kërkuar përsëri sasi të kokainës e më pas nga vetura N.i i kishte dhënë kokainë dhe që nga ajo kohë më nuk është parë me te.

Dëshmitari **P. M.** në deklaratën e tij të dhënë në Polici me datën 24.05.2019, ka deklaruar se të ndjerin N. e ka kushëri dhe me te ka pasur raporte shumë të mira. I ndjeri N. më së shumti është shoqëruar me M. K., M. Th.n dhe A. Th., që janë nga fshati . . . , si dhe me B. B.n nga fshati . . . , dhe këta persona janë në dijeni për jetën dhe aktivitetin e tije. I ndjeri N. para rastit ka qenë në burgë në Shqipëri, pasi që ka pasur një problem në Zvicër dhe pasi që është liruar nga burgu me te është takuar vetëm një herë. Në kohën para se të arrestohet N.i në Shqipëri derisa ky ishte në lokal ka ardhur dhe i ka kërkuar që ta dërgoi deri tek shtalla e M. K.t, të njëjtin e ka pritur dhe pasi që ka përfunduar bisedën me M.n është kthyer në makinë dhe i ka thënë se më duhen 20.000 Euro për transportimin rreth 3 kg, drogë jashtë Kosovës, të nesërmen kishte ardhur në lokal dhe i njëjti i kishte kërkuar veturën për 10 minuta dhe kur është kthyer duke nxjerr çelësin e veturës që të ia kthej kishte vërejtur se i njëjti kishte një sasi të madhe të parave në valutë prej 500 Euro. Nuk din se kush e ka vra të njëjtin por ka deklaruar se raportet me familjen i ka pasur të mira ndërsa është shoqëruar me personat e lartcekur dhe këta më së miri e din se kush mund të jetë vrasësi i tij.

Gjykata në cilësinë e ekspertit ka propozuar ekspertin mjeko-ligjor Dr. N. R. U., i cili ka deklaruar se i njëjti ka bërë obduksionin e viktimës së të ndjerit N. M., të cilën ekspertizë e kanë parashtruar në formë të shkruar ku kanë përshkruar dëmtimet e brendshme dhe shkakun e vdekjes të njërit N., nëse vdekja e tij ka ardhur si rezultat i gjakderdhjes së brendshme në krahërorë, si pasojë e plagës tej shkuese nëpër regjionin e zemrës, e shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrit dhe në bazë të kërkesës së prokurorisë kam përpiluar dhe një ekspertizë plotësuese të cilën e kam parashtruar në formë të shkruar dhe jam përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga prokurori i çështjes dhe në raportin tim kam shënuar të gjitha detajet dhe gjetjet në bazë të së cilave kemi konstatuar kohën e përafërt të vdekjes së të ndjerit ku përcaktimi i kohës varet dhe shumë faktorë ndër të cilat më e rëndësishëm është dallimi në mes të temperaturës kufomore dhe temperaturës së ambientit në të cilën është gjetur tani i ndjeri. Është marr parasysh konstruksioni fizik i të ndjerit, veshmbathja e tij, dallimi i temperaturës së ambientit me temperaturën e jashtme, është marr parasysh dallimi mes temperaturës ditore dhe asaj brenda natës, e duke pasur parasysh po ashtu dhe stinën dhe muajin në të cilin ka ndodhur rasti, e nga të gjitha këto së bashku janë vendosur në formularin e memogramit, në bazë të së cilës edhe kemi ardhur në përfundim se vdekja e të ndjerit ka ndodhur 7 deri në 13 orë para matjes së temperaturës kufomore, që do të thotë se vdekja ka ndodhur nga ora 22:00/h të datës 08.05.2019, deri në ora 03:00/h të datës 09.05.2019. gjatë analizimit të vendit të pre supozuar të ngjarjes nuk kemi gjetur asnjë element apo gjetje mjeko-ligjore jashtë ambientit ku është gjetur viktimja, që do të na obligonte që do të analizojmë gjetjet e mundshme për të dyshuar në vendin e vërtetë të ngjarjes, prandaj në mungesë të gjetjeve mjeko-ligjore në ambientin e hapur me besueshmëri të lartë profesionale kemi konstatuar se vendi i vdekjes është në shupë, pra vendi ku është gjetur viktimja. I ndjeri ka pasur dy plagë, njëra plagë ka qenë e shkaktuar me mjet të fortë e tjetra me armë të zjarrit dhe me besueshmëri deklaroi se plaga në regjionin e kokës është shkaktuar para plagës që është shkaktuar nga arma e zjarrit, pozicioni i plagës në regjionin e kokës me besueshmëri të lartë profesionale ka qenë gjerësa viktimja ka qenë në pozitë vertikale dmth, në këmbë, ndërsa plaga në regjionin e gjoksit po ashtu është shkaktuar në pozicion vertikal. Në pyetje të gjykatës se në bazë të gjurmëve të gjetura në vendin e ngjarjes ku është gjetur kufoma, se a ka mundur këtu i ndjeri të ekzekutohet në ndonjë vend tjetër dhe të bihet në vendin ku është gjetur kufoma, eksperti ka deklaruar se në këtë rast të gjitha provat e mundshme që i kemi grumbulluar nga

ekzaminimi i vendit të ngjarjes e deri në përfundim të të gjitha procedurave mjeko-ligjore, nuk kemi pasur asnjë provë materiale që dëshmon ndonjë mundësi të bartjes së kufomës nga një vend në një vend tjetër, respektivisht nga ambienti i hapur në ambientin e mbyllur ku është gjetur kufoma.

Ka bërë leximin e raportit fillestar të incidentit të datës 09.05.2019, me numër 2019:EB-186, raportin e shpejtë të datës 09.05.2019, me numër 2019-EB-186, ka bërë leximin e raportit të oficerit F. C. të datës 09.05.2019 me numër të njejtë të rastit, ka bërë leximin e raportit informues me numër 2019-EB-189 të datës 09.05.2019, ka bërë shikimin e raportit të vendit të ngjarjes të datës 09.05.2019 me numër 2019-EB-189, ka bërë shikimin e skicës së vendit të ngjarjes me legjendën e datës 09.05.2019 me numër të njejtë të rastit, ka bërë shikimin në fotoalbumin e vendit të ngjarjes me numër dhe datë të njejtë, ka bërë shikimin në raportin mjekësor të datës 09.05.2019, e lëshuar nga Dr. V. M., të QKMF në . . . , ka bërë shikimin në raportin e policit B. K. me numër ID#4596 të datës 26.07.2019, ka bërë shikimin në raportet e hetuesit rreshterit M. K. të datës 09.05.2019,07.05.2019 dhe 26.07.2019, raporti i hetuesit A. H. të datës 14.05.2019, ka bërë shikimin në raportin e hetuesit E. J. nga analiza e listingut dhe hartografisë së viktimës datës 31.05.2019, raportin e hetuesit E. J. të datave 21.06.2019, 03.07.2019 , raporti i hetuesit-reshterit H. S.u i datës 28.08.2019, ka bërë shikimin në raportin e ekspertimit e përpiluar nga AKF me numër Ref-AKF/2019-0202. datës 29.05.2019, ka bërë shikimin në raportin e autopsisë së të ndjerit N. M. i përpiluar nga eksperti mjeko ligjor Dr. N. U. me numër MA19-121 të datës 10.05.2019, ka bërë shikimin në raportin plotësues mbi autopsinë e të ndjerit e përpiluar nga Dr. N. U. datës 08.09.2019, si dhe ka bërë shikimin në shënimet zyrtare të datës 28.01.2020, me numër të rastit 2019\_EB-186.

Gjykata pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre edhe në lidhshmëri njëra me tjetrën ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datën 08.05.2019, mes orës 23:00/h, e gjerë në ora 03:00 të datës 09.05.2019, në fshatin . . . , Komuna e Rahovecit, në shtëpinë e të ndjerit N. M., është gjetur pa shenja jete në shup i ndjeri N. M., i cili ka qenë i qëlluar me një të shtënë nga revolja e kalibrit të panjohur në pjesën e përparme të krahërorit e si rezultat i kësaj i njëjti ka pasur gjakderdhje të brendshme të krahërorit si pasojë e plagës tej shpuese nëpër regjion të zemrës që është shkaktuar nga veprimi i predhës së hedhur me armë zjarri.

Për vërtetimin e fakteve nga aktakuza ndaj të akuzuarit A. M., janë administruar provat të propozuara nga prokuroria, janë marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarëve e dëmtuara K. M., nëna e të ndjerit, L. M., motra e të ndjerit, F. Q., Xh. M., B. B., M. Th., A. Th., M. Th., E. M., vëllai i të ndjerit, M. M.,G. Th.,si dhe ka bërë leximin e deklaratave të dëshmitarëve me P.in e palëve që kanë dhënë në prokurori, dhe atë të dëshmitarëve N. K. dhënë në prokurori me datën 08.11.2019 dhe deklaratat e dëshmitarëve L. V. të dhënë në polici me datën 24.05.2019, dëshmitares V. M. e dhënë në polici me datën 30.05.2019 si dhe dëshmitarit P. M. e dhënë në polici me datën 17.09.2019, si dhe ka marrë në pyetje ekspertin mjeko ligjor Dr.N. U. dhe ka lexuar raportet policore të cekura si në aktakuzë.

Në këtë çështje penale janë dëgjuar numër i konsiderueshëm i dëshmitarëve që janë familjarë i të ndjerit si dhe dëshmitarët me të cilët është shoqëruar i ndjeri si dhe i akuzuari dhe nga dëshmia e tyre të dhënë si në polici dhe prokurori dhe gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor nuk ka dyshim se kjo vrasje është kryer mirëpo nga dëshmia e tyre nuk vërtetohet që kryesi i kësaj veprë penale është këtu i akuzuari A. M.. Të gjithë këta dëshmitar në procesverbal vërtetojnë faktin se raporti në mes të viktimës dhe të nderit pra vëllait me vëlla para natës

kritike apo më herët nuk kanë pasur ndonjë mos marrëveshje apo konflikti e këtë më së miri e dëshmojnë anëtarët e tij të familjes si nëna e tij, motra dhe vëllai që raportet familjare kanë qenë në nivel dhe nuk kanë pasur konflikte apo mos marrëveshje. Ndërsa dëshmitarët me të cilët është shoqëruar këtu i ndjeri po ashtu theksoi se raportet e tija me familjarët e tij i ka pasur në rregull, i njëjti nuk ka shprehur ndonjë shqetësim që të ketë shprehur tek ata për raporte jo të mira në familje, andaj nga dëshmia e tyre nuk është vërtetuar asnjë fakt me të cilën e ngarkon aktakuza të akuzuarin A..

Në cilësinë e dëshmitarit është marr në pyetje eksperti mjeko-ligjor Dr.N. U., përpiluesi i raportit të autopsisë dhe nga kjo ekspertizë është vërtetuar shkaku e vdekjes së të ndjerit, vdekja ka ardhur si rezultat i gjakderdhjes së brendshme në krahërorë nga plaga tejshkuese në regjionin e zemrës të shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrit dhe nga ekspertiza plotësuese e bërë nga ana e ekspertit është përcaktuar koha e cila ka kaluar nga momenti kur është shkaktuar vrasja deri në momentin kur është gjetur trupi i pa jetë i viktimës nga anëtarët e familjes së tij dhe sipas konstatimit të tij i njëjti ka deklaruar se me besueshmëri të lartë koha e vdekjes ka kaluar nga 7 deri në 13 orë nga momenti i vdekjes e deri në kohën e matjes së temperaturës kofomore dhe të ambientit, duke pasur parasysh dhe dallimin në mes të temperaturës së ambientit gjatë natës dhe ditës si dhe faktorë rreth e potencuar nën pikën 1.1 të ekspertizës plotësuese ku është cekur se temperatura trupore është vetëm njëri nga shumë elementet që bazohet për caktimi i kohës së vdekjes dhe kursesi nuk mund të përcaktohet koha e vdekjes vetëm nga krahasimi i temperaturës trupore me temperaturën e ambientit, temperatura trupore dhe e ambientit janë matur rreth orës 10:10 minuta, të datës 09.05.2019, duke dhënë vlerat: temperatura e ambientit =15.3 oC: Temperatura trupore =27.3oC, dhe në bazë të kësaj koha e përafërt e momentit të vdekjes lëvizë nga ora 22:00/h, e datës 08.05.2019 deri në ora 03:00/h, të datës 09.05.2019. Po ashtu në pyetje të gjykatës se është lëvizur kufoma apo është vrarë në vendin ku është gjetur trupi i pa jetë i viktimës i njëjti ka deklaruar se bazuar në raportin dhe fotografitë nga vendi i ngjarjes në oborrin e shtëpisë nuk janë gjetur asnjë shenjë gjaku, pellg gjakua po mjet (arma e zjarrit apo mjetë mbrehës dhe i fortë) që kanë shkaktuar plagët-shkyese, ndrydhëse në regjionin e djathtë murorë të kokës dhe plagë tejshkuese në regjionin e majtë të gjoksit, prandaj vendi i shenjëzuar në numrin 1 përjashtohet të jetë vendi i vdekjes, në mungesë të provave mjeko-ligjore dhe sa i përket plagët që ka në kokë viktimën, të konstatohet se është plagë e shkaktuar në të njëjtën kohë kur është vrarë viktimën apo ka mundur të shkaktohet para apo pas vdekjes së tij eksperti ka deklaruar se plaga shkyese ndrydhëse në regjionin e djathtë të mblorë të kokës, bazuar në karakteristikat e plagës me besueshmëri ka qenë e shkaktuar para vdekjes së të ndjerit, ndërsa lidhur me plagën e cila ka qenë pas kokës së viktimës, a ka mundur të jetë shkaktuar gjatë rrëzimit në dysheme prej betoni, apo të jetë pasojë e goditjes me ndonjë mjetë të fortë apo të mbrehtë eksperti ka deklaruar se plaga shkyese ndrydhëse e konstatuar në regjionin të djathtë tëmbëllo të kokës është shkaktuar nga veprimi i mjetit të fortë mbrehtës, e cila nuk mund të përjashtohet në plotëni dhe mundësinë e shkaktimit të plagës gjatë rrënximit në dyshemenë prej betonit dhe në pyetjen e fundit të parashtruar ekspertit se a mund të bartet trupi i viktimës me duart nga një person i vetëm dhe a ekziston mangësia që lihen gjurmët, hematome (shenja dhune) në trupin e pa jetë të viktimës, i njëjti ka deklaruar se duke pasur parasysh konstruksionin fizik të tani më të ndjerit nuk përjashtohet mundësia e bartjes së viktimës edhe nga një person i vetëm edhe pse është shumë pak e besueshme që të mos të mbesin njolla gjaku gjatë bartjes dhe në mungesë të gjurmëve në venin e supozuar të vendit të ngjarjes përjashtohet mundësia e bartjes nga një vend në vend tjetër, andaj me besueshme të lartë ka deklaruar se vendi i vdekjes ka qenë brenda në shupën ku është gjetur viktimën.

Po ashtu nga raporti i ekspertimit nga Agjensionit Kosovar i Forenzikës me numër referues AKF/2019-0202 të datës 14.06.2019, për vërtetimin e mundshëm të grimcave të barutit nga dëshmitë që janë gjetur në vendin e ngjarjes dhe nga mendimi përfundimtar i AKF-së i përpiluar nga eksperti për eksploziv, grimcat e barutit dhe zjarrvënësja M. T. U.j, dhe eksperti i dytë verifikues S. D. Drejtori i Departamentit për Kimi dhe Biologji Forenzike është dhënë mendimi përfundimtar se në tubin (diskun) objekt ekspertimi nga dëshmitë: #1,#1,#4 dhe #5, nuk u evidentuan mikrogrimca unike me përbërje të tre elementeve kimik me prejardhje nga kapsula e armës së zjarrit, në mungesë të mbetjeve të grimcave me prejardhje nga kapsolla e armës në duart e personit pasi që këto dëshmitë nuk u evidentua prania e nitrateve dhe nitrateve të cilat janë të pranishme dhe të mbetjet e qitjes nga arma e zjarrit me prejardhje nga baruti, andaj edhe nga kjo ekspertizë përjashtohet që këtu i akuzuari është involvuar në këtë rast.

Andaj trupi gjykues në mungesë të provave të drejtpërsëdrejti materiale të cilat nuk përmbajnë rrethana të njohura faktike e të sigurta prej të cilave mund të vërtetohet ekzistimi i ndonjë prove të drejtpërsëdrejti për të akuzuarin, nuk është vërtetuar motivi i kryesit të veprës penale nga provat e administruara i cili në mënyrë tërthortë të njëjtin e implikoi në kryerjen e veprës penale, në rastin konkret nuk është gjetur arma, nuk janë gjetur gëzhojat. Andaj nga provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimeve gjyqësore, deklaratave të dëshmitarëve të propozuara si në aktakuzë si dhe nga mbrojtja e të akuzuarit nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit qëndrojnë elemente e veprës penale për të cilën është akuzuar pasi që nga dëshmia e dëshmitarëve familjarëve të tij, si dhe dëshmitë e dëshmitarëve shokët e të ndjerit, në dëshmitë e tyre prokuroria nuk ka mund të vërtetoi me asnjë provë të vetme që këtu i akuzuari A. M. është kryesi i kësaj veprë penale ngase nga provat e administruara të mbrojtjes së të akuzuarit aktakuza përkatësisht pretendimet e sajë kanë mbetur të pa vërtetuara si në dispozitiv të aktakuzës.

Andaj në mungesë të provave Trupi Gjykuese të akuzuarin e ka liruar nga akuza nga se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penale, interpretohen në favor të pandehurit dhe të drejtat e tija.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës që të bije në llogari buxhetore të kësaj Gjykate, bazohen në dispozitat e nënti 454 prg 1 të KPPK-se.

Andaj Gjykata komform dispozitave të nënti 364 prg 1 pika 1. 3 ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
-Departamenti për krime të Rënda-  
PKR.nr. 160/2020, te dt. 03.02.2021**

**Procesmbajtësja  
Nushe Kadrija**

**Kryetari i Trupit Gjykuese  
Shaqir Zika**



**KËSHILLA JURIDIKE**, kundër këtij aktgjykimit palët e pakënaqur mund të ushtrojnë ankesë në afate prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, neper mjetë kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.